

SFONDI ESTETIK NË POEMËN “DASHURIA” (EROS) TË NAIM FRASHËRIT

Hyrje

Letërsia orientale, përmes poezisë mistike, kaloi në letërsinë dhe në kulturën shqiptare. Naim Frashëri është personifikim i kësaj ure të kalimit të vlerave mistike orientale në hapësirat shqiptare.¹ Temat mbi të cilat do të qëndrojmë dhe të cilat janë qendrore në poezinë e Naimit, janë: Zoti, e bukura, dashuria dhe ekstaza, si rrugë për arritjen te Zoti.

Këto vlera te Naimi janë pjesë e pandarë e formimit intelektual të tij. Idetë e tij mbi të bukurën janë të shpërndara në vepra të ndryshme, por në poemën “Eros” (dashuria), ai e paraqet në mënyrë tërësore botëkuptimin e tij mbi këto çështje. Te Naimi ndikim të madh kishin poetët persianë: Xhelaluddin Rumi, Farid ud-din Attari, Ibn Arabiu etj., pasi ai i lexonte veprat e tyre në gjuhën origjinale. Ndikimi i tyre vërehet në konceptin e njëshmërisë së qenies (vahdeti vuxhud), e cila ndihet në tërë veprimtarinë e Naimit dhe shpeshherë edhe quhet *panteizëm*, sipas konceptit perëndimor. Por panteizmi i tij nuk është i llojit perëndimor të Spinozës, ai është panteizëm i stilit oriental, konkretisht koncept i filozofisë islame. E them këtë, duke u bazuar në atë që Naimi e unifikon Zotin me të bukurën dhe dashurinë, e njëjtë kjo me unifikimin që bëu Rumi në veprat e tij, në dallim nga Spinoza, i cili e kërkon unifikimin e Zotit në bazë të intelektit. Spinoza e kërkon Zotin tek etika, kurse Rumi dhe Naimi tek estetika.

Dashuria dhe estetika në poezinë e Naimit

E bukura, sipas filozofisë islame, i ka rrënjët në transcendencë, kurse shpërfaqja e saj është pjesa e marrë nga bukuria transcendente në vetvete. Procesi i kapjes së kësaj të bukure kërkon një çelje, hapje (fet’h), çlirim i

1 Mr. Qazim Qazimi, *Ndikime orientale në veprën letrare të Naim Frashërit*, botues: KBI-Gjilan, Prishtinë 1996, f. 8.

drejtë i të përtëjshmes.² E bukura në vetvete është e pandarë nga qenia reale dhe e domosdoshme (vuxhud), shtrirja e saj në hapësirë është prehja që sjell me vete, e cila ndikon në formimin e një ndërgjegjeje të pastër te njeriu (vixhdan), kurse përjetimi i saj kërkon ekstazën (vexhd). Në kuptimin etimologjik këto koncepte vijnë nga gjuha arabe dhe kanë të njëjtën rrënjë të fjalës (*v-xh-d*)³ dhe në kuptimin terminologjik në teozofinë islame këto formojnë një trekëndësh etiko-estetik i cili ndikon në edukimin e njeriut. Pa ndërgjegje të pastër nuk mund të ketë ekstazë dhe pa ekstazë nuk mund të arrihet qenia. Prandaj këto aspekte të së bukurës, të ndërgjegjes morale dhe të magjepsjes nga e bukura përherë ecin paralel me njëra – tjetrën dhe janë tema qendrore të artit, tesavufit dhe filozofisë islame, të gjendura edhe të poezia e Naimit.

Zoti është burimi i bukurisë dhe çdo gjë e bukur në një mënyrë, zbulon diçka nga bukuria absolute. Atributi i bukurisë që shfaqin, është në realitet atribut hyjnor i shfaqur përmes formave natyrore. Për sa kohë e bukura është e pranishme, edhe Zoti është i pranishëm së bashku me të. Në këtë aspekt, Zoti është në çdo gjë, por, në të njëjtën kohë, i ndarë nga gjërat. Bukuria në vetvete implikon dashurinë, madje ato janë sinonime me njëra-tjetrën. Ajo që shihet si e bukur, ndjehet përbrenda si dashuri. Për kudondodhjen e bukurisë dhe dashurisë hyjnore Naimi shprehet:

*Ti je çdo gjë, o Zot, Ti bota e hapësisë,
Ti nisja e mbarimi, Ti shpirti i gjithësisë,
Dhe dashuria ime, Je vet o Perëndi!
Çdo gjë je ti, këtu, edhe kudo je ti,
As dritë tempulli, as yll që ndritë,
Por çdo gjë që është, shkëlqimi yt.⁴*

Zoti, përveçse shfaqet te bota me atributin e bukurisë, ai shfaqet edhe te njeriu. Naimi i thur lavde dashurisë si alkimi e cila e bëri njeri njeriun. Po të mos ishte dashuria, njeriu do të mbetej në gjendjen e pluhurit. Për këtë esencë të njeriut Naimi shprehet në një poezi tjetër, ku thotë:

Që ta bënte njeri baltën, Zoti shpejt, nga yt det, një pikë hodhi mbi të drejtë.⁵

2 Metin Izeti, *Pasqyra estetike e traditës pereniale*, botues: SHQK "Vizioni-M", Shkup, 2018, f. 18.

3 Isa Memishi, *Fjalor arabisht-sbqip*, Sh.B. "Logos-A", Shkup, 2014.

4 Naim Frashëri, *Vëpra I*, "Rilindja", Prishtinë, 1986, f. 230.

5 Po aty, f. 80.

Meqenëse ndenja estetike te njeriu buron që nga zanafilla, pra është pjesë e identitetit parazanafillor të njeriut, ai e bart barrën e gjykimit estetik si përvojë transcendentë në botën reale.

Atributet hyjnore ndahen në dy grupe: Atributet e madhësisë (xhelal) dhe të bukurisë (xhemal). Padyshim, si njëra, ashtu edhe tjetra, si entitete hyjnore shfaqen te njeriu. E bukura shfaqet te bota, kurse madhështia te njeriu. Më pas, brenda natyrës njerëzore madhështia shfaqet te mashkulli, kurse bukuria te femra. Plotësia shfaqet te mashkulli, kurse pafundësia te femra.⁶

Në filozofinë perëndimore, tek Imanuel Kanti është diskutuar e madhërishtja dhe e bukura si objekte të gjykimit estetik. Për ta bërë të qartë idenë estetike të Naimit, do ta krahasojmë me estetikën kantiane e zhvilluar në filozofinë e artit perëndimor.

Sipas Kantit, bota është shpërfaqje e ndërgjegjes dhe rruga e arsyes drejt pastrimit është rrugë e cila pastron edhe ndërgjegjen për pasqyrimin sa më real të sendeve. Pas dy kritikave, asaj të gjykimit dhe kritikës së arsyes praktike, vjen kritika e gjykimit (e shijes).⁷ Te Kanti bota është përmbushje e kohës me hapësirë dhe këto dy entitete, koha dhe hapësira, janë shqisa apriori, të cilat ndihmojnë drejt gjykimit estetik të shëndoshë. Por pasiguria paraqitet, sepse te Kanti, përveç të bukurës, sublimja sjell me vete edhe frikën.⁸ Frika është pathelbësia ontologjike e gjykimit estetik.

Në dallim nga Kanti, te sufistët ndërgjegjja (vixhdan) pastrohet përmes ekstazës (vexhd) dhe jo përmes arsyes, sepse arsyeja nuk mund ta kapë të përtëjshmen, kurse bota është manifestim i entiteteve potencialisht kontingente, të cilat në aktin e perceptimit dalin jashtë për t'iu paraqitur soditësit. Frika mbetet vetëm në aspektin teologjik dhe jo në atë estetik. Dallimi qëndron në atë që në tesavuf origjina estetike i përket vetes primordiale te njeriu, pra është një shqisë e amshueshme e cila percepton përmes hapjes (fet'h), kurse te Kanti ajo është shqisë e përbotshme dhe ndriçohet përmes arsyes së kulluar, e cila i ngjan idesë platonike. Sufistët e quajnë arsyen të pamjaftueshme, prandaj ia shtojnë edhe përvojën mistike. E bukura e paraqitur te femra, sipas tesavufit

6 Joseph E. B. Lombard, *Islami, fundamentalizmi dhe traditimi i traditës*, Sh.B. "Logos-A", Shkup, 2016, f. 397-399.

7 Shih Gilles Deleuze, *Filozofia kritike e Kantit*, përkthet nga origjinali Elvis Hoxha, Sh.B. "Zenit", Tiranë, 2009, f. 164-165.

8 Imanuel Kant, *Mbi të bukurën dhe të madhërishten*, shqipëroi Urim Nerguti, Botimet "Pema", Tiranë, f. 15-20.

islam, është alegori e së bukurës së pafundme imanente, pasi femra është simbol i botës, sipas thënieve profetike. Kjo pafundësi padyshim që mban brenda vetes edhe plotësinë. Në tesavufin islam femra në raport me mashkullin arrin plotësinë, pra thënë në gjuhën e alegorisë, Hava unifikohet me Ademin, kurse mashkulli në raport me femrën përjeton pafundësinë e Zotit. Në raport me horizontet e gjata dhe të gjera të bukurisë natyrore, përherë synohet pafundësia.⁹ Për këtë arsye, e bukura e përbotshme është e personifikuar me femrën, gjë që e gjejmë edhe te Naimi, i cili pafundësinë e kupton edhe si ngopje, plotësi në vetvete, kur thotë:

*Kundruall meje, Afërditën,
 Me shtat të hedhur shikoj,
 Ajo është hyjnesha ime,
 Dhe më gjë tjetër s'kërkoj!*¹⁰

Më tej thotë:

*Me nektar pavdekësie,
 Po më freskon dashuria,
 E nga zemra e pikëlluar,
 Po shpërndan dhimbjet e mia.*¹¹

Në artin islam përherë e bukura duhet të jetë edhe e mirë. Kërkohej një lidhje mes etikës dhe estetikës, si rrugë drejt lumturisë së të dy botëve. Magjepsja nga e bukura domosdo duhet të shkaktojë efekt në shpirtin e njeriut dhe përulja shpreh akt adhurimi. Zoti, i cili paraqitet përmes trajtës natyrore dhe i bëhet i afërt njeriut, ia sjell atij të gjitha atotribute qenësore që njeriut i duken si të largëta. Nëse ekstaza nga dashuria hyjnore sjell dehjen mistike, edhe ekstaza nga natyra e sjell po atë dehje, siç thotë edhe Naimi:

*Po humbas mendjen, sa mrekullorë.
 Janë atje sipër, trupat qiellorë.
 Dhe duke parë, se fsheh habinë
 Befas se shoh më Uraninë.*¹²

9 Joseph E. B. Lumbard, *Islami, fundamentalizmi dhe traditimi i traditës*, Sh.B. "Logos-A", Shkup, 2016, f. 400.

10 Naim Frashëri, *Veptra I*, "Rilindija", Prishtinë, 1986, f. 222.

11 Po aty.

12 F. 228.

Nëse furnizimi lidhet me natyrën, atëherë falënderimi për begatinë domosdo buron nga një ndjenjë lumturie për njeriun. Naimi thotë:

*Dhe bujku kur sheh bollëk në prodhime, Zotit të madh i thur
lavdërimi.*¹³

Brenda perceptimit mistik të fesë, shpeshherë falënderimi është parë më lart sesa adhurimi i detyrueshëm. Kjo për arsyen se adhurimin e kërkon Zoti, kurse falënderimi është veprim i lirë dhe vjen si pasojë e vetëdijes për hyjnoren. Në këtë marrëdhënie shprehet një ndërlidhje mes vetëdijes fetare dhe etikës.

Një element tjetër i përbashkët i Naimit me poetët sufistë është paraqitja e bukurisë si urti në krijim, një lloj shpirti i botës, i cili e dirigjon botën përmes ligjeve të saj.

*Me të vërtetë, feja jote,
Njerëzimi vet,
Një shpirt ne jemi ndaj Perëndisë,
Miq e vëllezër ndaj dashurisë.*¹⁴

Dashuria, përveçse konceptohet si “telos”, prej të cilit ka ardhur bota në ekzistencë, në aspektin social të ndërtimit të rendit shoqëror ajo krijon kuptimin e përbashkët (hissi i mushterek), ku i gjithë njerëzimi bëhet një organizëm i gjallë, përmes lidhjes vëllazërore. Koncepti kuranor i “vëllazërisë” ka kuptimin social të ndjenjës së përbashkët. Rumi e shpreh në këtë formë: “Nuk merren vesh ata që flasin të njëjtën gjuhë, por ata që kanë të njëjtat ndjenja”.¹⁵ Pra, nuk mund të ndërtohet harmonia vetëm nga ata që flasin të njëjtën gjuhë, por kërkohet edhe ndjenja e përbashkët, e ngulitur te dashuria reciproke.

Bibliografia

1. Mr. Qazim Qazimi, “Ndikime orientale në veprën letrare të Naim Frashërit”, botues: KBI-Gjilan, Prishtinë 1996.
2. Dr. Metin Izeti, “Pasqyra estetike e traditës pereniale”, botues: SHQK “Vizioni-M”, Shkup, 2018.
3. Naim Frashëri, “Vepra I”, botues: “Rilindja”, Prishtinë, 1986.
4. E. B. Lumbard, “Islami, fundamentalizmi dhe tradhëtimi i traditës”,

13 Po aty, f. 228.

14 Po aty, f. 231.

15 Mesnevi, vëll. II, vargu 3681.

- Sh.B. “Logos-A”, Shkup, 2016.
5. Gilles Deleuze, “*Filozofia kritike e Kantit*”, përktheu nga origjinali Elvis Hoxha, Sh.B. “Zenit”, Tiranë, 2009.
 6. Isa Memishi, “*Fjalor arabisht-shqip*”, Sh.B. “Logos-A”, Shkup, 2014.
 7. Imanuel Kant, “*Mbi të bukurën dhe të madhërishmen*”, shqipëroi Urim Nerguti, Botues: “Pema”, Tiranë, 2017.
 8. Rumi, “*Mesnevi*”, përktheu nga persishtja Dr. Mithat Hoxha, Sh.B. “Logos A”, Shkup, 2010.